



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1098/7 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

V E N D I M

Nr.272, datë 26 .11.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa ankesa nr. 163, datë 17.07.2025¹, e znj. Xh. P.,² kundër Shoqërisë së Transportit “Maren Buss” sh.p.k³, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, znj. Xh. P., pretendon se në datën 11.07.2025, ka udhëtuar me urban nga sheshi Pranvera për të shkuar në Plepa, Durrës. Kur ka arritur tek stacioni i tregut industrial të plazhit, i është kërkuar nga faturinoja që të paguante biletën, por ajo i ka thënë dhe treguar kopjen e noterizuar të librezës e cila tregon se është invalide e verbër e grupit të dytë, pra me aftësi të kufizuar. Faturinoja i ka thënë se nuk e njihte të noterizuar librezën, në prezencë ka qenë edhe kontrolli i biletave të linjës, i cili është shprehur se kopja e noterizuar e librezës nuk njihet. E njëjta situatë i ka ndodhur dhe më datën 14.07.2025, po me të njëjtin faturino, kur ka hipur në autobusin e Plepa për në Durrës. Autobusi kishte targat AA 692 TP, njëri, dhe tjetri AA 341 XV.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

¹ Ankesa është plotësuar me shkresën e dërguar nga ankuejai, të protokolluar me tonën me nr. 1098/4, datë 01.08.2025.

² Referuar Librezës së Verbërisë nr. 30490, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, znj. P., është e verbër Grupi II.

³ NUIS L41720501P.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas verifikimeve të kryera nga ana e Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 1098/2 prot., datë 27.07.2025, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Me shkresën nr.15135/1 prot., datë, 04.08.2025⁴, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Nga verifikimi në zbatim të Udhëzimit nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe në platformën elektronike eTransport, rezulton se mjeti me targë AA 692 TP dhe AA 341 XV, ofrojnë shërbimin në linjën e transportit urban Durrës-Plepa-Durrës. Nga verifikimi në system rezulton se mjetet me targë AA 692 TP dhe AA 341 XV, janë në pronësi të subjektit “Maren Buss” sh.p.k., me NIPT L41720501P.

Pas shqyrtimit paraprak të saj, konstatohet se ankesa, kishte mangësi të anës formale që lidhen me faktimin apo provueshmërinë e pretendimit të diskriminimit nga ana e faturinos së autobusit me targë AA 692 TP dhe AA 341 XV, që ofron shërbimin në linjën e transportit urban Durrës-Plepa-Durrës.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 1098/3 prot., datë 28.07.2025, i është drejtuar për marrjen e informacionit palës ankuese nga e cila është kërkuar plotësimin e saj.
- Me shkresën nr. 1098/4 prot., datë 01.08.2025 është administruar informacion shtesë nga pala ankuese në lidhje me plotësimin e ankesës.

Pas plotësimit të ankesës dhe identifikimit të subjektit, u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa objekt shqyrtimi plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 dhe 334 të LMD. Në

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.1098/5 prot., datë 05.08.2025.

këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj, duke ndërmarrë hapat e mëposhtme:

- Me shkresën nr.1098/6 prot., datë 06.08.2025, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Durrës dhe Shoqëria “Maren Buss” sh.p.k, me NIPT L41720501P, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, sim ë poshtë:

Nga ana e Bashkisë Durrës:

- Kopje të kontratës së shërbimit mes Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë së transportit “Maren Buss” sh.p.k që ushtron aktivitetin në linjën Durrës-Plepa-Durrës.
- Kopje të plotë të licencës të lëshuar nga Bashkia Durrës për mjetet e Shoqërisë “Maren Buss” sh.p.k, me targa: AA692TP dhe AA341XV.
- Informacion cilat janë masat e ndërmarra nga ana e Bashkisë për verifikimin dhe zgjidhjen e problematikës së parashtruar nga ankuesja? Parashtrimet tuaja dhe aktet shkrese provuese, nëse ka.
- Informacion lidhur me monitorimin e shërbimit të operatorëve të transportit të udhëtarëve, me të cilët Bashkia ka marrëdhënie kontraktuale, për periudhën gjatë viteve 2023-2025.

Nga ana e Shoqërisë së transportit “Maren Buss” sh.p.k:

- Informacion nga ana e Shoqërisë “Maren Buss” sh.p.k, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankueses.
 - Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Maren Buss” sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në legjislacionin specifik.
 - Informacion lidhur me masat e ndërmarra nga ana e Shoqërisë për sqarimin e zgjidhjen e kësaj problematike.
 - Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
-
- Duke marrë shkas nga mosdërgimi i informacionit të kërkuar, nga ana e Komisionerit me shkresën nr. 1098/7 prot., datë 01.09.2025 është rikërkuar përsëri ky informacion.
 - Me shkresën nr.9693/2 prot., datë 12.09.2025⁵, Bashkia Durrës i ka përcjellë Policisë Bashkiake për ndjekje ankesën e z. Xh. P., *(për dijeni Komisionero)*.
 - Me shkresën nr.9693/3 prot., datë 12.09.2025⁶, Bashkia Durrës ka vënë në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
 - Me shkresën nr.1098/10 prot., datë 17.09.2025, Komisioneri, i ka përcjell pales ankuese për parashtrime shkresën nr.9693/2 prot., datës 12.09.2025 *(dokumentacionin bashkëlidhur)* të kësaj bashkie.

⁵ Administruar pranë Komisionerit me nr.1098/8 prot., datë 15.09.2025.

⁶ Administruar pranë Komisionerit me nr.1098/9 prot., datë 15.09.2025.

- Me shkresën nr. 9693/3 prot., datë 06.10.2025⁷, Policia Bashkiake i ka kthyer përgjigje Komisionerit në lidhje me rastin.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, por dhe të kërkesës së përsëritur me email e datës 23.09.2025 të inspektorit të çështjes, Shoqëria “Maren Buss” sh.p.k me e-mailin 23.09.2025, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: *Për sa i përket znj. Xh. P., është i njëjti rast me z. Xh. M., për të cilin ju kemi dërguar përgjigje. Në asnjë rast nga këto nuk është paraqitur pranë zyrave të kompanisë për t’u sqaruar. Në çdo kohë, në çdo moment janë të mirëpritur të vijnë, të ballafaqohen dhe të sqarohen Z. Xh. M., dhe Znj. Xh. P. Nga punonjësit tanë nuk kemi pasur asnjë sinjalizim për këtë lloj shqetësimi. Shqetësimet që ne hasim në punën tonë të përditshme në lidhje me të gjitha kategoritë që përfitojnë udhëtim pa pagesë janë mosposedimi i dokumenteve origjinale sipas legjislacionit, si më poshtë:*
 1. *Librezë anëtarësimi shoqate që është invalid (në më të shumtën e rasteve është e skaduar ose është librezë jashtë çdo rregulli ligjor).*
 2. *Mungesë e raportit mjekoligjor KEMP (në shumicën e rasteve është një fotokopje bardh e zi, e korrigjuar, e grisur, etj.).*
 3. *Shoqëruesit e invalidëve kërkojnë të udhëtojnë pa pagesë, kur invalidi nuk udhëton – pra kur janë jashtë veprimtarisë së shoqëruesit të invalidit.*

Falenderit për mirëkuptimin. Në çdo kohë dhe moment jemi gati për ballafaqim për çdo rast.

Sqarojmë: Nga ana e kompanisë është dhënë urdhër çdo punonjësi që të respektohet çdo individ që duhet të udhëtojë pa pagesë, konform ligjeve në fuqi.

- Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁸, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e ankuesit, caktoi datën 06.11.2025, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 1098/12 prot., datë 15.10.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua në praninë e të dyja palëve, përkatësisht palës ankuese, znj. Xh. P., si dhe përfaqësuesit të shoqërisë “Maren Buss”, z. B. A., i autorizuar nga administratori i shoqërisë. Gjatë seancës, palët qëndruan në të njëjtat pretendime të paraqitura më herët në komunikimet zyrtare. Pala ankuese parashtoi gjithashtu shqetësime të tjera të lidhura me ofrimin e shërbimit të transportit në këtë itinerar, të cilat nuk kanë qenë objekt i këtij ankimi.

Nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë u deklarua se, pavarësisht se shoqërisë nuk i kanë rezultuar të identifikuar pretendimet e ankueses, ai, duke marrë shkas nga problematikat e evidentuara prej

⁷ Administruar pranë Komisionerit me nr.1098/11 prot., datë 08.10.2025.

⁸ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

saj gjatë seancës, do të vijojë monitorimin e situatës dhe do të verifikojë çdo rast tjetër të pretenduar në lidhje me këtë linjë.

Përfaqësuesi i shoqërisë i sugjeroi dhe i sqaroi palës ankuese procedurat dhe mënyrat e ngritjes së ankesave pranë shoqërisë, si dhe shprehu gatishmërinë për të qenë më pranë saj dhe çdo problematike që lidhet me ofrimin e shërbimit në këtë linjë. Ai theksoi se kjo qasje mbështet jo vetëm trajtimin e ankesave të saj, por edhe të çdo ankuesi tjetër, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe adresimin në kohë të shqetësimeve të publikut përdorues.

- Me shkresën nr. 1098/15 prot., datë 06.11.2025 është administruar pranë Komisionerit, kërkesa për tërheqje nga ankesa e znj. Xh. P., si më poshtë:

Pas seancës dëgjimore të datës 06.11.2025 dhe shqyrtimit të ankesës time të bërë para Komisionerit, si dhe ballafaqimit me përfaqësuesin e shoqërisë Maren Buss, nga ana ime u sqaruan të gjitha pretendimet mia ku rezultoi që shoqëria ka reflektuar dhe ka marrë masa konkrete dhe në vijim do vijojt me monitorimin e rasteve për mos përsëritjen e situatave. Në këto kushte e quajmë të arritur qëllimin dhe tërhiqem nga ankesa. Gjithashtu kërkoj nga Komisioneri ti rekomandojë shoqërisë të marrë masa për përmirësimin e sjelljes së punonjësve të saj.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat reflektuese dhe veprimet konkrete të ndërmarra nga shoqëria “Maren Buss”, përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të linjës dhe trajtimin e çdo rasti të raportuar nga përdoruesit e shërbimit;
- Përmbushja e qëllimit të ankesës, pasi pala ankuese ka deklaruar tërheqjen nga ankesa pas sqarimit të plotë të pretendimeve dhe marrjes së garancive nga shoqëria për përmirësimin e situatës;
- Realizimi i qëllimit parandalues dhe ndërmjetësues të procedurës, nëpërmjet zgjidhjes miqësore dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe adresimin në kohë të shqetësimeve të udhëtarëve.

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 163, datë 17.07.2025, të znj. Xh. P., kundër Shoqërisë së Transportit “Maren Buss” sh.p.k duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur⁹.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 163, datë 17.07.2025, e znj. Xh. P., kundër Shoqërisë së Transportit “Maren Buss” sh.p.k, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Rekomandohet Shoqëria “Maren Buss” sh.p.k, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për mënyrën e ofrimit të udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;

⁹ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024.

- Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA